

Paraja publike e shpenzuar në media

Raport mbi shpenzimin financiar të
institucioneve shtetërore për informim publik







Autor: Ardian Nikolla


Redaktore: Albana Merja

Dizajni dhe faqosja: Gishtat creative touch

“Ky botim (ose publikim) është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.”

PËRMBAJTJA

I. Hyrje	4	b) Institucionet e nivelit qendrore	39
II. Metodologjia	5	1. Zyra e Presidentit	40
a) Institucionet e nivelit lokal	6	2. Kuvendi i Kosovës	41
1. Komuna e Prishtinës	8	3. Zyra e Presidentit	42
2. Komuna e Prizrenit	9	4. Ministria e Administratës Publike	43
3. Komuna e Pejës	10	5. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	44
4. Komuna e Gjakovës	11	6. Ministria e Drejtësisë	45
5. Komuna e Ferizajt	12	7. Ministria e Financave	46
6. Komuna e Gjilanit	14	8. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	47
7. Komuna e Mitrovicës	15	9. Ministria e Infrastrukturës	48
8. Komuna e Suharekës	16	10. Ministria e Integriteteve Evropiane	49
9. Komuna e Istogut	17	11. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	50
10. Komuna e Vitisë	18	12. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	51
11. Komuna e Malishevës	19	13. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	53
12. Komuna e Vushtrrisë	20	14. Ministria e Zhvillimit Ekonomik	54
13. Komuna e Podujevës	21	15. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	55
14. Komuna e Skenderajt	22	16. Ministria për Kthim dhe Komunitete	56
15. Komuna e Drenasit	23	17. Ministria e Diasporës	57
16. Komuna e Fushë Kosovës	24	IV. Përfundime dhe Rekomandime	58
17. Komuna e Dragashit	25		
18. Komuna e Hanit të Elezit	26		
19. Komuna e Junikut	27		
20. Komuna e Lipjanit	28		
21. Komuna e Mamushës	29		
22. Komuna e Obiliqit	30		
23. Komuna e Shtimes	31		
24. Komuna e Kamenicës	32		
25. Komuna e Klinës	33		
26. Komuna e Rahovecit	34		
27. Komuna e Deçanit	35		
28. Komuna e Novobërdës	36		
29. Komuna e Graçanicës	37		
30. Komuna e Kaçanikut	38		



I. HYRJJE

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) për herë të parë boton raportin “Paraja publike e shpenzuar në media”, për vitin 2016. Ky raport, heton dhe analizon shpenzimet e institucioneve të pushtetit qendror dhe atij lokal për informimin publik. Target i këtij hulumtimi janë të gjitha Komunitet e Kosovës, Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Zyra e Presidentit dhe Kuvendi i Kosovës.

Qëllimi kryesorë i këtij hulumtimi është të nxjerrë në pah mënyrën e shpenzimit të parasë publike nga institucionet e vendit gjatë vitit 2016 për informim publik, si dhe të hedhë dritë mbi arsyet se për çfarë janë shpenzuar këto mjete.

Ky hulumtim është zhvilluar nga muaji prill deri në gusht 2017 duke mbledhur të dhënat për shpenzimet e kryera gjatë vitit 2016. Ajo që vlen të theksohet është fakti që gjatë kohës së hulumtimit AGK-ja ka hasur në vështirësi të shumta burokratike - institucionale. Këto vështirësi kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në punën tonë, duke bërë kështu që mbledhja e të dhënave të mos bëhet në kohë të arsyeshme dhe brenda afateve të parapara në Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike në lidhje me pagesat, subvencionet ose grante për mediat të dhëna nga institucionet e pushtetit lokal dhe

atij qendror.¹ Për më tepër, AGK, në disa raste ka hasur edhe në mungesë të transparencës së publikimit të të dhënave nga institucionet përkatëse. Më konkretisht, një numër i konsiderueshëm i institucioneve nuk i janë përgjigjur kërkesës së AGK-së, rreth shpenzimeve për informim publik të bëra gjatë vitit 2016. Në nivelin e pushtetit lokal, nuk kemi marrë informacion nga shtatë (7) komuna. Komunitet që nuk i janë përgjigjur kërkesës tonë janë komuna të cilat banohej dhe qeverisën nga komuniteti serb, me përjashtim të Graçanicës dhe Novobërdës, të cilat kanë bashkëpunuar me AGK-në. Ndërsa, në nivel qendror, kërkesës së AGK-së nuk i janë përgjigjur katër (4) nga gjithsej nëntëmbëdhjetë (19) ministrinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Për më tepër, një ministri ka dërguar të dhëna të tjera nga ato që janë kërkuar, dhe si të tilla nuk janë paraqitur në këtë raport.

¹ E qasshme në: (<https://gzk.rksq.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2724>)

II. METODOLOGJIA

Për hartimin e këtij raporti janë përdorur të dhëna parësore të mbledhura në mënyrë të drejtpërdrejtë nga institucionet e lartpërmendur. AGK-ja ka dërguar kërkesa për Qasje në Dokumente Publike në lidhje me pagesat për mediet vendore dhe të huaja për informim publik. Gjithashtu, është kërkuar informacion në lidhje me pagesat e subvencioneve dhe granteve të cilat janë ndarë nga institucionet lokale dhe ato qendrore për të gjitha mediet vendore ose të huaja. Kërkesat e AGK-së në drejtim të institucioneve të targetuara, janë dërguar më anë të postës elektronike, ku në shumicën e rasteve marrja e kërkesës është konfirmuar nga zyrtari përgjegjës i institucionit përkatës. Këtu vlen të theksohet fakti se komunat më të vogla janë treguar më të shpejta në kthimin e përgjigjeve në krahasim me komunat më të mëdha. Ndërsa, për institucionet të cilat nuk e kanë konfirmuar pranimin e kërkesës, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka dërguar edhe tri kërkesa të tjera (gjithsej katër kërkesa) elektronike si dhe ka bërë përpjekje maksimale që të grumbullojë të dhëna nga

të gjitha institucionet në mënyrë që ky raport të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe i kompletuar. Mirëpo, siç u përmend më sipër, disa komuna dhe ministri nuk i janë përgjigjur kërkesës së AGK-së. Ky hulumtim, paraqet një pasqyrim të detajuar mbi shpenzimin e institucioneve lokale dhe atyre qendrore për informim publik dhe vartësinë financiare të medieve që mund ta kenë nga këto institucione, vartësi kjo që mund të ndikoj drejtpërsëdrejti edhe në politikën mediale - redaktoriale e raportuese kundrejt institucioneve përkatëse.



III. ANALIZIMI I TË DHËNAVE

Dërgimi i të dhënave nga një pjesë e institucioneve, në veçanti atyre të pushtetit lokal edhe përkundër faktit se kanë qenë më të shpejta në kthimin e përgjigjeve, kanë pasur një kualitet dhe kuantitet të dobët, duke lënë shumë për të dëshiruar. Kjo për faktin se gjatë dërgimit të përgjigjeve, disa institucione nuk e kanë kuptuar përmbajtjen e kërkesës së Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, dhe për këtë kemi hasur në vështirësi të shumta, ku në raste të caktuara kemi pranuar të dhëna tejet konfuzë dhe të paqarta dhe më shumë vështirësi kemi arritur t'i nxjerrim konkluzionet e kërkuara nga këto institucione. Ajo që vlen të theksohet, është fakti që një numër i konsiderueshëm i shpenzimeve të grumbulluara nga komunat dhe ministritë nuk kanë qenë të kategorizuara. Për më tepër, disa nga institucionet nuk i kanë bërë të ditura arsyetimet se për çfarë i kanë shpenzuar këto mjete dhe, si të tilla në analizën më poshtme janë emërtuar si “Pa kategori”. Një tjetër aspekt sfidues gjatë realizimit të këtij hulumtimi ka qenë edhe mos sqarimi i arsyes së pagesave / kontratave të nënshkruar nga institucionet –


komunat me mediumet përkatëse. Të dhënat e grumbulluara janë analizuar me kujdes dhe janë strukturuar për secilin institucion. Gjithashtu, informacioni është ballafaquar me të dhënat e marra në faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP)² në lidhje me dhënien e tenderëve që kanë të bëjnë me fushën e informimit publik. Në të shumtën e rasteve ne kemi gjetur kontrata të publikuara nga institucionet në faqen e KRPP-së mirëpo, ka pasur institucione, kryesisht komuna të cilat nuk kanë publikuar kontrata dhe nuk kanë hapur tender publik për shërbime mediale. Këtë fakt disa nga komunat e kanë arsyetuar me faktin se në rajonet e tyre ka vetëm një medium lokal, me ç'rast janë thirrur në tenderët një burimor.

Analiza e këtij raporti është e ndarë në dy pjesë kryesore. Pjesa e parë paraqet dhe analizon të dhënat për secilën komunë të Kosovës, duke përjashtuar ato komuna që nuk kanë kthyer përgjigje. Ndërsa pjesa e dytë analizon këto të dhënat për secilin institucion qendror.

²E qasshme në: (<https://krpp.rks-gov.net>)

a) Institucionet e nivelit lokal

a) Institucionet e nivelit lokal



Shpenzimet të cilat i ka bërë secila komunë për informim publik janë paraqitur në grafikë të veçantë. Për më tepër, grafikët paraqesin dhe kategoritë se për çfarë janë shpenzuar mjetet financiare. Kategoritë kryesore të shpenzimeve për secilën komunë janë ndarë si në vijim:

- Shpallje, njoftime, publikime
- Reklama
- Transmetim i seancave të Kuvendit Komunal/ kryerje e shërbimeve mediale (përcjellje e aktiviteteve të institucioneve
- Subvencione (ndihma financiare)
- Pa kategori. (Nuk janë bërë të ditura kategoritë e shpenzimeve)

Ashtu siç u theksua dhe më parë shtatë komuna nuk i janë përgjigjur kërkesës së AGK-së. Këto komuna janë: Kllokoti, Parteshi, Shtërpca, Ranillugu, Zveçani, Lepasaviqi dhe Zubin Potoku.



1. Komuna e Prishtinës

Gjatë kohës që është zhvilluar ky hulumtim, komuna e Prishtinës ka bërë të ditur se për shpallje, njoftime, publikime dhe shërbime mediale ka paguar **11,452.44 €**. Ndërsa, sipas kësaj komune në proces të pagesës për shpallje, njoftime dhe publikime për vitin 2016 janë edhe **14,306.76 €**. Në total, komuna e Prishtinës përgjatë vitit 2016 për informim publik ka shpenzuar **25,761.20 €**. Nga komuna e Prishtinës kanë përfituar katër medime.

Në bazë të publikimeve të Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) të dhënies së tenderëve nga komuna e Prishtinës për vitin 2016, kjo komunë më datë 18.12.2015 ka nënshkruar kontratë me një medium / agjenci të lajmeve të cilin e kontraktuar për kryerjen e shërbimeve mediale. Vlera e përgjithshme e kësaj kontrate është **8,940.00 €**. Në këtë kontratë nuk është saktësuar kohëzgjatja e saj.




Fig. 1. Komuna e Prishtinës

2. Komuna e Prizrenit

Kjo komunë gjatë vitit 2016 për shpallje, njoftime, publikime ka shpenzuar **4,170.00 €**. Për transmetim të seancave të kuvendit komunal ka shpenzuar **9,750.00 €**. Ndërsa, për reklama ka shpenzuar **35,850.00 €**. Në total komuna e Prizrenit për informim publik ka shpenzuar **49,770.00 €**. Nga kjo komunë kanë përfituar njëmbëdhjetë (11) medime.

Në bazë të publikimeve në KRPP³ të dhënies së tenderëve nga komuna e Prizrenit, kjo komunë nuk ka bërë publik asnjë tender rreth shpenzimeve për informim publik për vitin 2016.

AGK ka kërkuar sqarime shtesë nga Komuna e Prizrenit në lidhje me pagesat / kontratat me tre (3) televizionet lokale të cilat në bazë të të dhënave kanë përfituar shuma materiale relativisht të larta nga kjo komunë në krahasim me mediet e tjera. Në këtë kërkesë, AGK ka kërkuar sqarime në lidhje me formën e pagesës si dhe, nëse ka pasur proces të tenderimit për këto medime. Mirëpo komuna e Prizrenit nuk ka dhënë asnjë sqarim në lidhje me kërkesën e parashtruar nga ne.




Fig. 2. Komuna e Prizrenit

³E qasshme në: (<https://krpp.rks-gov.net>)

3. Komuna e Pejës

Kjo komunë gjatë vitit 2016 për transmetim të seancave të kuvendit komunal ka shpenzuar **10,000.00 €**. Nga komuna e Pejës ka përfituar vetëm një medium / televizion lokal.

Kontrata ndërmjet mediumit / televizionit dhe komunës së Pejës nuk është publikuar në KRPP. Zyrtarë të Komunës së Pejës kanë thënë se “kontrata ndërmjet komunës dhe mediumit ka qenë pa tender publik, për arsye se në atë komunë ka vetëm një televizion lokal. Kjo kontratë vlerësohet si kontratë një burimore”.⁴



Fig. 3. Komuna e Pejës

⁴Ariana Lukaj e-mail autorit me datë 11.04.2017

4. Komuna e Gjakovës




Fig. 4. Komuna e Gjakovës

Kjo komunë gjatë vitit 2016 ka shpenzuar **32,928.13 €**, duke mos i ndarë në kategori shpenzimet për mjete e shpenzuara. Gjithashtu, kjo komunë ka ndarë edhe subvencione (ndihmë financiare) për një medium / radio lokale në vlerë prej **722.00 €**.⁵ Nuk janë dhënë arsyet e subvencionimit të këtij mediumi nga ana e komunës së Gjakovës. Në bazë të të dhënave të dërguara nga komuna e Gjakovës, ky institucion në total ka shpenzuar **33,650.13 €**. Nga komuna e Gjakovës kanë përfituar gjithsej nëntë (9) medime.

Në bazë të publikimeve të dhënies së tenderëve nga komuna e Gjakovës, në faqen e KRPP-së kjo komunë ka publikuar kontratën me një televizion lokal të lidhur me datë **15/04/2016** për transmetim të seancave të Kuvendit Komunal, si dhe për përcjelljen e aktiviteteve të tjera të Komunës së Gjakovës. Vlera e përgjithshme e kësaj kontrate është **50,000.00 €**. Në shumën e llogaritur të shpenzimeve financiare për vitin 2016 nga Komuna e Gjakovës, llogaritet edhe një pjesë e mjeteve financiare e kësaj kontrate, mirëpo nuk dihet saktësisht sa është shuma e shpenzuar nga kjo kontratë, sepse nuk është përcaktuar kohëzgjatja e saj.

⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2524>



5. Komuna e Ferizajt

Komuna e Ferizajt gjatë vitit 2016 për reklama ka shpenzuar **97,280.00 €**. Ndërsa, për transmetim të seancave të Kuvendit Komunal kjo komunë ka shpenzuar **9,000.00 €**. Në total, Komuna e Ferizajt ka shpenzuar **106,280.00 €**. Nga komuna e Ferizajt kanë përfituar nëntë (9) medime.

Kontrata ndërmjet komunës së Ferizajt dhe një mediumi lokal për transmetim të seancave të kuvendit komunal është nënshkruar me 26.06.2015 dhe ka përfunduar me 25.06.2016. Vlera e kësaj kontrate ka qenë **18,000.00 €**. Në e kemi llogaritur vetëm pjesën e dytë të kësaj kontratë që është gjashtë muhori i parë i vitit 2016, për arsye se edhe hulumtimi ka të bëjë me atë periudhë kohore të shpenzimit të komunave për informim publik për vitin 2016. Ndërsa, në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga komuna e Ferizajt, kjo komunë me datën 14.10.2016 ka nënshkruar kontratë me disa medie private lokale të ndarë në katër LOT'e. Në lotin e parë kjo komunë ka nënshkruar kontratë me një medium në vlerë prej 45,600.00 €. Në lotin e dytë komuna e Ferizajt ka nënshkruar kontratë me një medium tjetër në vlerë prej 7,200.00 €. Në lotin e tretë

komuna e Ferizajt ka nënshkruar kontratë me një medium në vlerë prej 42,300.00 €. Ndërsa në lotin e katërt komuna e Ferizajt ka nënshkruar kontratë në vlerë prej 34,000.00 €. Të gjitha këto kontrata kanë kohëzgjatje prej 12 muajsh. Vlen të theksohet se komuna e Ferizajt është komuna që ka shpenzuar më së shumti mjete financiare për informim publik gjatë një viti.

5. Komuna e Ferizajt



Fig. 5. Komuna e Ferizajt



6. Komuna e Gjilanit

Kjo komunë gjatë vitit 2016 ka shpenzuar **37,981.00 €**, të cilat nuk i ka ndarë në kategori specifike se për çfarë i ka shpenzuar. Nga komuna e Gjilanit kanë përfituar (10) mediume.

Në bazë të publikimeve në KRPP, komuna e Gjilanit e ka publikuar një tender me një medium lokal në vlerë prej **9,068.00 €** të nënshkruar me 03.05.2016 për reportazh të seancave të Kuvendit Komunal.

AGK ka kërkuar informacion shtesë nga Komuna e Gjilanit në lidhje me shumën e paguar ndaj një mediumi në vlerë prej **20,210.00 €**. Kemi kërkuar informacione se a ka pasur kontratë ndërmjet komunës së Gjilanit dhe mediumit, sepse gjatë analizimit të të dhënave kemi parë se ky medium ka përfituar më shumë mjete financiare në krahasim me mediumet e tjera. Mirëpo, komuna e Gjilanit nuk ka dhënë sqarime rreth kësaj pagese. Po ashtu, në bazë të kërtimeve në KRPP nuk figuron ndonjë kontratë ndërmjet komunës së Gjilanit dhe këtij mediumi.



Fig. 6. Komuna e Gjilanit

7. Komuna e Mitrovicës



Kjo komunë, gjatë vitit 2016 ka shpenzuar **18,100.00 €**. Edhe komuna e Mitrovicës nuk e ka bërë ndarjen e shpenzimeve në kategori specifike. Nga kjo komunë kanë përfituar tre (3) medime.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga komuna e Mitrovicës, ky institucion më datën 27.04.2016 ka nënshkruar kontratë në vlerë prej **61,200.00 €** me një medium / televizion lokal për informim të qytetarëve për aktivitetet e komunës. Sipas të dhënave në draftin e nënshkrimit të kësaj kontrate, kohëzgjatja e saj është 36 muaj. Në shumën e llogaritur të shpenzimeve financiare për vitin 2016 nga Komuna e Mitrovicës, llogaritet edhe një pjesë e mjeteve financiare nga kjo kontratë.

Fig. 7. Komuna e Mitrovicës



8. Komuna e Suharekës

Kjo komunë, gjatë vitit 2016 për shpallje, njoftime, publikime ka shpenzuar **3,700.05 €**, të ndara për tre medime.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve kjo komunë me datën 15.08.2016 ka nënshkruar kontratë në vlerë prej **3,540.00 €** me një medium / televizion lokal për transmetim të seancave të kuvendit komunal. Kohëzgjatje e kësaj kontrate ka qenë 12 muaj.



Fig. 8. Komuna e Suharekës

9. Komuna e Istogut



Kjo komunë, gjatë vitit 2016 për shpallje, njoftime, publikime ka shpenzuar **16,135.00 €**. Nga komuna e Istogut kanë përfituar tre (3) medime.

Me një nga medimet / televizionet që Komuna e Istogut i ka kontraktuar, kjo komunë bënë të ditur se “kontrata me këtë medium është kontratë një burimore, sepse ky televizion është mediumi i vetëm kombëtar në rajonin e Pejës dhe për këtë arsye komuna ka lidhur kontratë një burimore”.⁶

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve, kjo komunë ka publikuar kontratën e nënshkruar një medium / gazetë me datë 16.05.2016 në vlerë prej 3.157.00 € për publikime. Kohëzgjatja e kësaj kontrate është 36 muaj.

Komuna e Istogut ka bërë publike për AGK-në, edhe një kontratë tjetër të nënshkruar me 12.12.2014 me një medium / radio lokale në vlerë prej 3,000.00 € në vit për publikime të njoftimeve të Komunës së Istogut. Kohëzgjatja e kësaj kontrate është 36 muaj.

Fig. 9. Komuna e Istogut

⁶Jeta Balaj e-mail autorit më datë 14.04.2017



10. Komuna e Vitisë

Gjatë vitit 2016, komuna e Vitisë për shpallje, njoftime, publikime ka shpenzuar **1,635.00 €**, ndërsa për transmetim të seancave të Kuvendit Komunal ka shpenzuar **5,860.00 €**. Në total komuna e Vitisë ka shpenzuar **7,495.00 €**. Nga kjo komunë kanë përfituar gjithsej tetë medime.

Në bazë të publikimeve në KRPP për dhënie të kontratës, kjo komunë me datë 12.09.2015 ka nënshkruar kontratë me një medium / televizion lokal për transmetim të seancave të Kuvendit Komunal në vlerë prej **5,860.00 €**. Kohëzgjatja e kësaj kontrate ka qenë 12 muaj.




Fig. 10. Komuna e Vitisë



11. Komuna e Malishevës

Kjo komunë gjatë vitit 2016 për shpallje, njoftime, publikime ka shpenzuar **6,687.00 €**, ndërsa për reklama dhe konkurse ka shpenzuar **3,525.00 €**. Në total kjo komunë ka shpenzuar **10,212.00 €**, nga të cilat kanë përfituar gjithsej tre medime.

Në bazë të publikimeve të KRPP të dhënies së tenderëve nga Komuna e Malishevës nuk figuron asnjë kontratë që kjo komunë e ka nënshkruar me ndonjë medium për informim publik.




Fig. 11. Komuna e Malishevës



12. Komuna e Vushtrrisë

Kjo komunë ka shpenzuar gjatë vitit 2016 për shpallje, njoftime, publikime **995.00 €**, ndërsa për transmetim të seancave të kuvendit komunal ka shpenzuar **2,299.64 €**. Në total komuna e Vushtrrisë ka shpenzuar **3,294.64 €**.

Në bazë të publikimeve të KRPP kjo komunë me datë 01.09.2016 ka nënshkruar kontratë me një medium / radio lokale në vlerë prej **10.772,19 €** për transmetim të seancave të Kuvendit Komunal. Kohëzgjatja e kësaj kontrate është 36 muaj.




Fig. 12. Komuna e Vushtrrisë



13. Komuna e Podujevës

Kjo komunë gjatë vitit 2016 ka shpenzuar gjithsej **3,163.00 €**. Nga të cilat **669.00 €** janë shpenzuar për shpallje, njoftime, publikime dhe **2,494.00 €** për reklama. Nga komuna e Podujevës kanë përfituar katër medime.

Në bazë të publikimeve në KRPP-së, Komuna e Podujevës më datë 16.05.2016 ka nënshkruar kontratë në vlerë prej **3,080.00 €** me një medium / gazetë për publikime. Kohëzgjatja e kësaj është 24 muaj.




Fig. 13. Komuna e Podujevës



14. Komuna e Skenderajt

Kjo komunë gjatë vitit 2016 ka shpenzuar **9,094.70 €**, shpenzime këto të cilat nuk janë kategorizuar. Nga komuna e Skenderajt kanë përfituar pesë medime.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga Komuna e Skenderajt, nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo komunë e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.



Fig. 14. Komuna e Skenderajt

15. Komuna e Drenasit

Gjatë vitit 2016 kjo komunë ka shpenzuar për shpallje, njoftime, publikime **1,698.00 €**, ndërsa për transmetim të seancave të kuvendit komunal ka shpenzuar **1,849.00 €**. Në total Komuna e Drenasit ka shpenzuar **3,547.00 €**. Nga kjo komunë kanë përfituar katër medime.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga komuna e Drenasit, nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo komunë e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.




Fig. 15. Komuna e Drenasit

Komuna e Fushë Kosovës

16. Komuna e Fushë Kosovës

Kjo komunë gjatë vitit 2016 për shpallje, njoftime, publikime i ka shpenzuar **1,980.00 €**. Nga komuna e Fushë Kosovës ka përfituar vetëm një medium/gazetë.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga komuna e Fushë Kosovës, nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo komunë e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.



Fig. 16. Komuna e Fushë Kosovës

17. Komuna e Dragashit



Kjo komunë gjatë vitit 2016 për transmetim të seancave të kuvendit komunal ka shpenzuar **5,725.00 €**. Nga kjo komunë kanë përfituar dy medime / radio lokale.

Në bazë të publikimeve në KRPP-së, të dhënies së tenderëve nga komuna e Dragashit nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo komunë e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.

Fig. 17. Komuna e Dragashit



18. Komuna e Hanit të Elezit

Kjo komunë ka shpenzuar **1,410.00 €** gjatë vitit 2016 për reklama. Nga komuna e Hanit të Elezit kanë përfituar tre medime.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga komuna e Hanit të Elezit, nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo komunë e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.



Fig. 18. Komuna e Hanit të Elezit

19. Komuna e Junikut



Kjo komunë gjatë vitit 2016 për shpallje, publikime, njoftime ka shpenzuar **1,300.00 €**. Nga Komuna e Junikut kanë përfituar gjithsej tre medime.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga komuna e Junikut nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo komunë e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.

Fig. 19. Komuna e Junikut



20. Komuna e Lipjanit

Kjo komunë gjatë vitit 2016 në total ka shpenzuar **5,635.95 €**, nga të cilat **3,935.95 €** për shpallje, publikime, njoftime si dhe **200.00 €** për reklama, ndërsa ka dhënë subvencione (ndihmë financiare) për një medium lokal në vlerë prej **1,500.00 €**. Nga komuna e Lipjanit kanë përfituar katër medime, si dhe një është subvencionuar.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga komuna e Lipjanit, nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo komunë e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.




Fig. 20. Komuna e Lipjanit

21. Komuna e Mamushës



Kjo komunë gjatë vitit 2016 për shpallje, njoftime, publikime ka shpenzuar **100,00 €**. Nga komuna e Mamushës ka përfituar vetëm një medium.

Fig. 21. Komuna e Mamushës

22. Komuna e Obiliqit

Gjatë vitit 2016 për shpallje, njoftime, publikime ka shpenzuar **2,400.00 €**. Nga komuna e Obiliqit ka përfituar vetëm një medium.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga komuna e Obiliqit, nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo komunë e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.



Fig. 22. Komuna e Obiliqit

23. Komuna e Shtimes



Kjo komunë gjatë vitit 2016 për shpallje, njoftime, publikime ka shpenzuar **2,520.00 €**. Nga kjo komunë ka përfituar vetëm një medium lokal.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga komuna e Shtimes, kjo komunë ka bërë publik kontratën me mediumin lokal për shpallje dhe publikime në vlerë prej **2,000.00 €**. Kjo kontratë është nënshkruar me datë 15.03.2016 dhe ka skaduar me 31.12.2016.

Fig. 23. Komuna e Shtimes



24. Komuna e Kamenicës

Kjo komunë gjatë vitit 2016 për shpallje, njoftime, publikime ka shpenzuar **1,140.00 €**, ndërsa për reklama ka shpenzuar **2,000.00 €**. Nga komuna e Kamenicës kanë përfituar tre mediume. Në total, kjo komunë ka shpenzuar **3,140.00 €**.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga komuna e Kamenicës, nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo komunë e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.




Fig. 24. Komuna e Kamenicë

25. Komuna e Klinës



Kjo komunë gjatë vitit 2016 ka shpenzuar **1,800.00 €**. Kjo komunë nuk i ka kategorizuar shpenzimet. Nga komuna e Klinës ka përfituar vetëm një medium.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga komuna e Klinës, nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo komunë e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.

Fig. 25. Komuna e Klinës



26. Komuna e Rahovecit

Kjo komunë gjatë vitit 2016 ka shpenzuar **7,356.00 €**. Komuna e Rahovecit nuk i kanë publikuar emrat e medieve si dhe nuk i ka kategorizuar arsyetimet se për çfarë janë shpenzuar këto mjete financiare.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga komuna e Rahovecit, kjo komunë ka publikuar kontratën e nënshkruar me një agjenci të lajmeve më datë 02.09.2016 në vlerë prej **8,856.00 €**. Kohëzgjatja e kësaj kontrate është 12 muaj.



Fig. 26. Komuna e Rahovecit

27. Komuna e Deçanit



Kjo komunë gjatë vitit 2016 për shpallje, njoftime, publikime ka shpenzuar **475.00 €**. Nga komuna e Deçanit ka përfituar vetëm një medium/radio.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga komuna e Deçanit, nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo komunë e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.

Fig. 27. Komuna e Deçanit

28. Komuna e Novobërdës

Kjo komunë gjatë vitit 2016 për shpallje, njoftime, publikime, ka shpenzuar **300.00 €**. Nga komuna e Novobërdës ka përfituar vetëm një medium/radiotelevizion lokal.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga komuna e Novobërdës, nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo komunë e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.



Fig. 28. Komuna e Novobërdës

29. Komuna e Graçanicës



Kjo komunë gjatë vitit 2016 për shpallje, njoftime, publikime ka shpenzuar **836.00 €**. Nga komuna e Graçanicës kanë përfituar dy medime/radio lokale.


Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga komuna e Graçanicës nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo komunë e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.

Fig. 29. Komuna e Graçanicë

Komuna e Kaçanikut

30. Komuna e Kaçanikut

Kjo komunë ka bërë të ditur se përgjatë vitit 2016 nuk ka bërë asnjë shpenzim për informim publik.



b) Institucionet e nivelit qendror

b) Institucionet e nivelit qendror

Në këtë pjesë janë analizuar të dhënat nga Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, Kuvendi i Kosovës si dhe Ministrinë e Qeverisë së Kosovës (përveç atyre që nuk kanë kthyer përgjigje). Edhe në këtë pjesë të raportit, me anë të grafikëve, janë paraqitur të gjitha shpenzimet për secilin institucion si dhe janë analizuar të dhënat e mbledhura gjatë hulumtimit.

Vlen të theksohet se katër nga ministrinë e Qeverisë së Kosovës nga 19 gjithsej nuk kanë kthyer asnjë përgjigje në lidhje me shpenzimet për informim të bëra gjatë vitit 2016, ndërsa një ministri ka dërguar të dhëna të tjera nga që janë kërkuar. Megjithëse, AGK-ja, ka dërguar në drejtim të këtyre ministrive katër kërkesa të njëpasnjëshme për qasje në dokumente publike, nuk kemi marrë asnjë përgjigje. Institucionet që nuk kanë kthyer përgjigje janë; Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Ndërsa, Ministria e Punëve të Brendshme, ka dërguar të dhëna të tjera nga ato që janë kërkuar.

Bazuar në analizën e të dhënave të mbledhura nga Zyra e Presidentit, Kuvendi i Kosovës, Zyra e Kryeministrit si dhe Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, janë katër kategori kryesore të shpenzimeve të këtyre institucioneve: Kategoritë kryesore të shpenzimeve për secilën institucion janë ndarë si në vijim:


- Shpallje, njoftime, publikime;
- Reklama
- Pa kategori
- Subvencion

Këto të dhëna janë analizuar dhe paraqitur në grafikët më poshtë.

Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë nuk kanë kthyer asnjë përgjigje, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme ka dërguar disa të dhëna, të cilat nuk i përgjigjen kërkesës së AGK-së.

1. Zyra e Presidentit

“Ky institucion gjatë vitit 2016 nuk ka bërë asnjë pagesë për mediet vendore e as për mediet e huaja për informim publik”.⁷



⁷Florent Rrahmi e-mail autorit me datë 27.04.2017

2. Kuvendi i Kosovës



Gjatë vitit 2016 Kuvendi i Kosovës për shpallje, njoftime, konkurse ka shpenzuar **6,662.55 €**. Nga ky institucion kanë përfituar pesë medime.

Fig. 2. Kuvendi i Republikës së Kosovës



3. Zyra e Kryeministrit

Kjo zyrë, ka bërë të ditur se ka një kontratë me një medium / gazetë për publikime në vlerë prej **3,090.00 €**, për publikime. Vlera monetare sipas Zyrës së Kryeministrit është për periudhën 22.07.2015 deri me 14.04.2017. Në bazë të përpjesëtimeve të kësaj vlere, Zyra e kryeministrit gjatë vitit 2016 ka arritur ti shpenzoj përafërsisht **1,545.00 €**. Nga Zyra e Kryeministrit ka përfituar vetëm një medium.

Ndërkaq, në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga Zyra e Kryeministrit, kjo zyrë më datë 08.06.2015 ka nënshkruar një kontratë me një medium në vlerë prej **4,180.00 €**.

Gjithashtu, zyra për komunitete në Zyrën e Kryeministrit përgjatë vitit 2016, ka dhënë grante për 35 medie dhe OJQ-ve (në kuadër të së cilave operojnë një numër i medieve të regjistruara si OJQ) kryesisht të komuniteteve jo shqiptare, në veçanti të ⁸ komunitetit serb në vlerë prej **188, 000.00 €**. Në total Zyra e Kryeministrit për publikime dhe grante për vitin 2016 ka shpenzuar **189,545.00 €**.



Fig. 3. Zyra e Kryeministrit

⁸<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2524>

4. Ministria e Administratës Publike



Kjo ministri gjatë vitit 2016 për shpallje, njoftime, publikime, urime ka shpenzuar **7, 595.00 €**. Nga Ministria e Administratës Publike kanë përfituar tetë mediume

Ndërkaq, në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga Ministria e Administratës Publike, nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo ministri e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.

Fig. 4. Ministria e Administratës Publike

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

5. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Gjatë vitit 2016 kjo ministri për reklama dhe konkurse ka shpenzuar **1,770.05 €**. Nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kanë përfituar katër medime.

Bazuar në të dhënat e në faqen e KRPP, kjo ministri me 19.02.2016 ka nënshkruar kontratë për reklama dhe konkurse me një medium / gazetë në vlerë të përafërt rreth 2,000.00 €. Çmimi i kësaj kontrate për njësi është **161.00 €**. Kohëzgjatja e kësaj kontrate është 12 muaj.



Fig. 5. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

6. Ministria e Drejtësisë



Kjo ministri gjatë vitit 2016 për shpallje, njoftime, publikime ka shpenzuar **4,773.43 €**. Nga Ministria e Drejtësisë kanë përfituar katër medime.

Ndërkaq, në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga Ministria e Drejtësisë, nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo ministri e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.

Fig. 6. Ministria e Drejtësisë



7. Ministria e Financave

Gjatë vitit 2016 kjo ministri ka shpenzuar për shpallje, njoftime, publikime **8, 847.00 €**. Nga Ministria e Financave kanë përfituar pesë medime.

Ndërkaq, në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga Ministria e Financave nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo ministri e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.



Fig. 7. Ministria e Financave

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

8. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Kjo ministri gjatë vitit 2016 ka shpenzuar gjithsej **33,162.60 €** për informim publik, nga të cilat **31,374.10 €** janë shpenzuar për shpallje, njoftime, publikime dhe **1,788.50 €** për reklama dhe konkurse. Nga Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës kanë përfituar gjashtë medime.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, kjo ministri me datë 22.06.2015 ka nënshkruar kontratë me 15 medime për kryerjen e shërbimeve mediale elektronike dhe të shkruara për nevojat të MFSK-së dhe FSK-së në vlerë prej **30,000.00 €**. Kohëzgjatja e kësaj kontrate ka qenë 24 muaj.




Fig. 8. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

9. Ministria e Infrastrukturës

Gjatë vitit 2016 për shpallje, njoftime, publikime dhe botime ka shpenzuar **7,995.00 €**. Nga kjo ministri kanë përfituar tetë medime.

Sipas publikimeve të KRPP-së, të dhënies së tenderëve nga Ministria e Infrastrukturës nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo ministri e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.



Fig. 9. Ministria e Infrastrukturës

Ministria e Integritimeve Evropiane

10. Ministria e Integritimeve Evropiane

Kjo ministri gjatë vitit 2016 ka shpenzuar **6,822.00 €**, nga të cilat **2,872.00 €** për shpallje, njoftime, publikime dhe për **3,950.00 €** nuk i ka kategorizuar shpenzimet. Nga Ministria e Integritimeve Evropiane ka përfituar një medium.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga Ministria e Integritimit Evropian, kjo ministri me datë 04.11.2016 ka nënshkruar kontratë me një medium / gazetë për publikime në vlerë prej **1,510.00 €**. Në këtë publikim nuk është përcaktuar kohëzgjatja e kësaj kontrate.




Fig. 10. Ministria e Integritimeve Evropiane

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit



11. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Kjo ministri gjatë vitit 2016 për shpallje, njoftime, publikime ka shpenzuar **29, 673.12 €**. Nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kanë përfituar tetë medime.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kjo ministri me datë 07/07/2015 ka nënshkruar kontratë me një medium / agjenci të lajmeve në vlerë prej **9,600.00 €** për mbulimin e aktiviteteve të ministrisë. Kohëzgjatja e kësaj kontrate nuk është përcaktuar.



Fig. 11. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit



12. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Në total Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për informim publik për vitin 2016 ka shpenzuar **58,670.30 €**. Për shpallje, njoftime, publikime ka shpenzuar **53,836.50 €**, ndërsa për reklama ka shpenzuar **4,833.80 €**. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk i ka bërë publike emrat e as numrin e medieve përfituese.

Sipas publikimeve të KRPP-së të dhënies së tenderëve nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kjo ministri me datë 06.04.2015 ka nënshkruar kontratë me një medium / gazetë në vlerë prej **223,50 €** për njësi për publikime. Në këtë njoftim të dhënies së kontratës nuk është precizuar numri total i njësive e as kohëzgjatja e kësaj kontrate.

Gjithashtu, në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kjo ministri me datë 03.03.2016 ka nënshkruar kontratë me një medium / agjenci të lajmeve në vlerë prej 300.00 € për njësi (shërbime medial) për video- incizimin e aktiviteteve

publike të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Në këtë njoftim të dhënies së kontratës nuk është përcaktuar numri i njësive (shërbimeve mediale) të kryera nga mediumi përfitues për MPH-në. Kohëzgjatja e kësaj kontrate ka qenë 12 muaj.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



12. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Fig. 12. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

13. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Kjo ministri përgjatë vitit 2016 i ka shpenzuar **5,400.00 €**, të cilat nuk i ka kategorizuar. Nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kanë përfituar tre medime.

Vlen të përmendet se në publikimet e KRPP-së nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo ministri e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.



Fig. 13. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Ministria e Zhvillimit Ekonomik



14. Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Bazuar në të dhënat e grumbulluara kjo ministri gjatë vitit 2016 ka shpenzuar në total **19, 299.00 €**. Pjesën më të madhe të të cilave, e ka shpenzuar për reklama, më konkretisht **14, 525.00 €**. Ndërsa për shpallje, njoftime dhe publikime ka shpenzuar **4,774.00 €**. Nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik kanë përfituar 14 mediume.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, kjo ministri më datë 28.02.2016 ka nënshkruar kontratë me një medium / agjenci të lajmeve në vlerë prej 3.945.00 € për punimin e video-raporteve nga takimet dhe aktivitetet e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Kohëzgjatja e kësaj kontrate është 24 muaj.




Fig. 14. Ministria e Zhvillimit Ekonomik

15. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Gjatë vitit 2016 kjo ministri ka shpenzuar **54,567.19 €**. Vlen të theksohet fakti se edhe pse ka shpenzuar një shifër të konsiderueshme, kjo ministri nuk i ka kategorizuar këto shpenzime. Nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kanë përfituar 39 medime.

Në bazë të publikimeve në KRPP të dhënies së tenderëve nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kjo ministri më datë 18.03.2015 ka nënshkruar kontratë me një medium / agjenci të lajmeve në vlerë prej 10.000.00 € apo 430.00 € për njësi për mbulim të aktiviteteve mediale. Në njoftimin për dhënie të kontratës nuk është saktësuar numri i njësive si dhe kohëzgjatja e saj.



Fig. 15. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria për Kthim dhe Komunitete



16. Ministria për Kthim dhe Komunitete

Kjo ministri ka shpenzuar **200.00 €** gjatë vitit 2016 për shpallje, njoftime, publikime, urime €. Nga kjo ministri ka përfituar një medium.



Fig. 16. Ministria për Kthim dhe Komunitete

17. Ministria e Diasporës

Në total kjo ministri gjatë vitit 2016 ka shpenzuar **3,986.00 €** nga të cilat për reklama dhe konkurse ka shpenzuar **186.00 €**. Ndërsa ka ndarë subvencione (ndihma financiare) në vlerë prej **3,800.00 €**.⁹ Nga Ministria e Diasporës kanë përfituar tre medime një për reklama dhe shërbime si dhe dy medime nga diaspora janë subvencionuar.

Në bazë të publikimeve në KRPP nga Ministria e Diasporës nuk është gjetur asnjë tender publik që kjo ministri e ka dhënë gjatë vitit 2016 për shërbimet e informimit publik.




Fig. 17. Ministria e Diasporës

⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2524>

Përfundime dhe Rekomandime

IV. Përfundime dhe Rekomandime

Nga analizimi i të dhënave të institucioneve të pushtetit lokal, gjatë vitit 2016, komunat për informim publik kanë shpenzuar afërsisht **373, 161.67 €**. Numri i medieve që kanë përfituar nga këto institucione është rreth pesëdhjetë. Komuna e cila ka shpenzuar më se shumti për informim publik gjatë vitit 2016 është komuna e Ferizajt, me **106,280.00 €**. Ndërsa, komuna që nuk ka shpenzuar fare për informim publik është komuna e Kaçanikut.

Bazuar në të dhënat e analizuar mësipër, gjatë vitit 2016 institucionet e nivelit qendror të Republikës së Kosovës kanë shpenzuar për informim publik afërsisht **250,968.69 €**, duke ia shtuar kësaj edhe **188,000 €** grante të dhëna nga Zyra e Kryeministrit për 35 medie dhe OJQ përgjatë vitit 2016). Në total institucionet e nivelit qendror kanë shpenzuar, dhënë subvencione apo grante për mediat përafërsisht **438, 968.69 €**.

Numri i medieve që kanë përfituar nga institucionet qendrore është mbi pesëdhjetë. Institucioni qendror që ka shpenzuar më shumë mjete financiare për publikime dhe grante për vitin 2016 është

Zyra e Kryeministrit me **189,545.00 €**. Ndërsa, ministria që ka shpenzuar më pak për informim publik është Ministria për Kthim dhe Komunitete më vetëm **200.00 €** të shpenzuara.

Institucionet e pushtetit lokal dhe atij qendror për informimin publik për vitin 2016 kanë shpenzuar përafërsisht **624,130.36 €**, duke ia shtuar kësaj edhe **188,000 €** grante të dhëna nga Zyra e Kryeministrit. Në total institucionet e vendit kanë shpenzuar / dhënë subvencione dhe grante për mediat në vlerë prej **812, 130.36 €**.

Buxheti i Kosovës për vitin 2016 ka qenë 1 miliard e 674 milion euro. Ndërsa, shuma e shpenzuar nga institucionet shtetërore për informim publik, subvencione dhe grante për mediet gjatë vitit 2016 është **812, 130.36 €**. Në bazë të përpjesëtimeve të shumës së buxhetit të vendit për vitin 2016 me shpenzimin e institucioneve për informim publik, del se 0.05 % e buxhetit të vendit për vitin 2016 është shpenzuar për informim publik nga ana e institucioneve lokale dhe atyre qendrore.

Përfundime dhe Rekomandime


IV. Përfundime dhe Rekomandime

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës gjatë analizimit të të dhënave të raportit “Paraja publike e shpenzuar në media”, ka vënë re disa parregullsi në lidhje me shpenzimet e informimit publik si nga institucionet qendrore ashtu dhe nga ato lokale. Në mënyrë që të kemi një situatë më transparente për sa i përket këtyre shpenzimeve është shumë e rëndësishme që institucionet e Kosovës të marrin parasysh rekomandimet e mëposhtme.

- 1. Institucionet duhet të bëjnë një kategorizim / ndarje më të qartë të të gjitha shpenzimeve për informim publik, duke përfshirë këtu dhënien e subvencioneve ose granteve për mediet.*
- 2. Çdo kontratë e lidhur ndërmjet institucionit dhe medieeve më qëllim të informimit publik të publikohet në faqen e KRPP-së.*
- 3. Institucionet lokale dhe qendrore duhet ta bëjnë informimin me kohë për hapjen e procedurave tenderuese për fushë e informimit publik, ku do të krijohet mundësi e barabartë për të gjitha mediet qofshin ato lokale ose nacionale për të aplikuar në thirrjen e institucioneve për kryerjen e shërbimeve mediale.*
- 4. Institucionet të tregojnë transparencë, përgjegjshmëri dhe pa-anshmëri gjatë procedurave të përzgjedhjes së medieeve përfituese për kryerjen e shërbimeve mediale.*
- 5. Institucionet lokale dhe ato qendrore të tregohen më të matura, më të përgjegjshme dhe më transparente në shpenzimin e parasë publike për informim publik dhe jo vetëm.*
- 6. Institucionet duhet t'i procedojnë më kohë dhe sipas afateve ligjore kërkesat për qasje në dokumentet publike si dhe të jenë më efikase e të hapura në kthimin e përgjigjeve që kanë të bëjnë më interesin publik.*

Institucionet Lokale

Institucionet Qendrore



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK)

Luan Haradinaj 100/10
10000 Pristina
Republika e Kosovës

www.agk-ks.org

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

“Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”.